ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i prokurimit	**214-23-13065-211**

Sa i përket tenderit për: Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së –Ri tender

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: "Beni Dona Plast: SH.P.K

Adresa : Lagja Ulpiana, Rruga Imzot Nikë Prelaj , Prishtine

Numri Telefonit: 038-500-894

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: Fadil Paçarada

Adresa elektronike: ***prokurimi.zyra@gmail.com***

Data e parashtrimit të ankesës: 15.04.2024

Nënshkrimi dhe vula:_____

BENI DONA PLAST SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR PRISHTINE

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. **B05- Njoftimi për kontrate: 24.11.2023**
2. **Afati për dorëzim te tenderit: 13.12.2023**
3. **Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët**
4. **Aneksi 5- Kërkesë për Informacione shtese: 04.12.2023**
5. **Kërkese për Rishqyrtim: 07.12.2023**
6. **Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 08.12.2023**
7. **B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 11.12.2024**
8. **Ankesa në OSHP: 18.12.2023**
9. **Vendimi i OSHP-se, nr: 2023/1027: 22.02.2024**
10. **B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 29.02.2024**
11. **Procesverbali i Hapjes se Ofertave: 11.03.2024**
12. **B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 26.03.2024**
13. **Kërkese për qasje ne dokumentet e tenderit: 26.03.2024**
14. **Përsëritje e Kërkesës për qasje ne dokumentet e tenderit:29.03.2024**
15. **Kërkese për Rishqyrtim: 02.04.2024**
16. **Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 04.04.2024**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			**Jo**	X
Hapja e ofertave është bere me datën 11.03.2024 ne ora 14:00					

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			**Jo**	☐

Autoriteti Kontraktues - Akademia e Kosovës për Siguri Publike, me datën 26.03.2024 ne platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po X **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 02.04.2024 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Me datën 04.04.2024 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse

aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Shkeljet e dispozitave - Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, janë:

Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (AK) – Akademia e Kosovës për Siguri Publike më datën **26.03.2024** në Platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Formularit – **B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit**

Pasi kemi shkarkuar nga Platforma e E-Prokurimit , Formularin – B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar, më datën **26.03.2024** kemi bere kërkese të Autoriteti Kontraktues për qasje në dokumentet e tenderit të Operatorit Ekonomik: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria. Për shkak të afatit shume të shkurte te ankimimit, kemi kërkuar që qasja mundësisht të na lejohet me datën **27.03.2024**.

Autoriteti Kontraktues- Akademia e Kosovës për Siguri Publike, tek me datën **28.03.2024** na ka lejuar qasje në dokumentet e tenderit të Operatorit Ekonomik: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria dhe dokumentet na i ka ngarkuar ne USB.

Kur përfaqësuesit e kompanisë tone Beni Dona PLast SHPK, jane kthyer ne zyrën tone, kane shfletuar dokumentet të cilat Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK, i ka ngarkuara në USB, dhe kane vërejtur se mungon dokumenti kryesor - **Autorizimi i prodhuesit apo dilerit,** të cilin së bashku me ofertën e ka dorëzuar **OE: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria.**

Bazuar ne faktin së ky veprim i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të Autoriteti Kontraktues Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, është shkelje substanciale e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, ne prape me datën **29.03.2024,** kemi dërguar të Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të AK- AKSP , kërkesën për të na lejuar qasje të plote në dokumentet e tenderit , konkretisht në Autorizimin e prodhuesit apo dilerit të cilin **OE: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria** e ka dorëzuar së bashku me ofertën, apo të njëjtin të na dërgoj përmes platformës së E-Prokurimit apo e-mailt zyrtar.

Fatkeqësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK- AKSP, prape vazhdoj me shkelje substanciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës duke mos na kthyer asnjë përgjigjeje lidhur me ri-kërkesën tone për qasje ne dokumentet e tenderit të datës **29.03.2024**.

Duke qene 100% të bindur së veprimet e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të AK- AKSP, (për të mos na lejuar qasje të plote në dokumentet e tenderit – **Autorizimin e prodhuesit apo dilerit,** të cilin së bashku me ofertën e ka dorëzuar OE: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria), janë në kundërshtim të plote me nenin **10 të LPP- paragrafi 3,4 dhe 5**, nenin **11 të LPP- paragrafi 3, nen paragrafi 3.1,3.2, dhe 3.3, si dhe nenin 7 të Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik, paragrafi 7.5, nen paragrafi (a) dhe (b),** ne me datën **02.04.2024,** kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Autoriteti Kontraktues- Akademia e Kosovës për Siguri Publike, vazhdoi prape me shkeljen substanciale të dispozitave të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik duke na e konsideruar si të pa bazuar Kërkesën tone për Rishqyrtim.
Arsyejet të cilat Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK- AKSP i ka shënuar, në Përgjigjen e datës **04.04.2024** , për refuzim të Kërkesën tone për Rishqyrtim, **janë të pa qëndrueshme dhe në kundërshtim të plote me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte.**

Çdo Zyrtare Përgjegjës i Prokurimit që ka njohuri elementare për legjislacionin e prokurimit publik e dine ose së paku duhet ta dije që vetëm disa nga dokumentet që kërkohen nga OE për ti plotësuar Kapacitetet Ekonomike dhe Financiarë – nenit 68 dhe Kapacitetet Teknike dhe Profesionale – nenit 69 , munden me u konsideruar si dokumente që janë si sekret afarist.

Në asnjë mënyre Autoriteti Kontraktuarës **nuk mund të konsideroj si sekret afarist** dokumentet që janë kërkuar për ti plotësuar kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale, siç është në rastin konkret **Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi apo dileri i autorizuar**.

Operatoret Ekonomik spekulues mund të bëjnë lloj lloj kërkesat për ti konsideruar të gjitha dokumentet si sekret afarist për të mos ju zbuluar spekulimet që i bëjnë me rastin e ofertimit, por është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues – Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që të veproj sipas legjislacionit të prokurimit publik dhe ta beje selektimin - vlerësimin së cilat dokumente mund të konsiderohen si sekrete afariste e cilat jo.

Kompania jonë në momentin që ka shkarkuar Dosjen e Tenderit ka vërejte që AK në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik, gjate ri tenderimit ka shtuar kërkesën për Autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar, (kërkese që asnjë here me pare mbi 20 vite nuk e ka kërkuar gjate zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit për furnizim me këto shërbime), ne kemi reaguar përmes kërkesës për sqarime të tenderit , Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Edhe sipas kërkesës për sqarime të tenderit, por edhe sipas Kërkesës për Rishqyrtim, AK nuk ka pranuar që të bëjë heqjen e kësaj kërkese diskriminuese, por vazhdoj me diskriminimin e të gjithë OE tjerë dhe favorizimin e OE të preferuar nga ana e AK.

Si rezultat e këtyre veprimeve dhe këtyre kërkesave diskriminuese, Zyrtaret e AK- AKSP, që një vit nuk arrijnë që me sukses ta përfundojnë ketë aktivitet të prokurimit por vazhdojnë që me kontrate ta shpërbleje të njëjtin OE që e kane shpërblyer për mbi 10 vite pa ndërpre që ne shume raste edhe duke përdore Proceduarën e Prokurimit pa Publikim të Njoftimit për Kontratë.

Vetëm për periudhën kohore **Maj 2023 - Shkurt 2024**, duke përdore ketë procedure jo transparente dhe pa e ftuar asnjë here kompaninë tone në negociata që është lider në Kosove sa i përket kryerjes se këtyre

shërbimeve, ka shpërblyer me kontrata OE të preferuar- OE: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria, në vlere prej **1,137,327.70 Euro.**

Është **ky lloj i Autoriteteve Kontraktuese** që me veprimet e tyre **anti ligjore,** kane ndikuar që vlera e kontratave sipas Proceduarës së Prokurimit pa Publikim të Njoftimit për Kontratë, gjate **vitit 2023** të arrije vlerën e afër **130 milion euro** ,që krahasuar me **vitin 2022 është dyfishuar vlera.**

Është pikërisht kjo kërkesa diskriminuese – Autorizimi qe e ka dështuar aktivitetin e prokurimit dhe nëse vazhdohet me kërkesa të tilla diskriminuese prape buxhetin e Republikës së Kosovës, do ta dëmtojë me qindra mijëra euro.

Fatkeqësisht edhe tani në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik, AK insiston me çdo kusht që ketë OE të preferuar nga AK ta mbroj duke na mohuar të drejtën tone elementare ligjore që të kemi qasje në dokumentet e tenderit, konkretisht në Autorizimin që ky OE ka dorëzuar së bashku me ofertën.

Për informim tuaj - Autorizimi nga Prodhuesi ose Dileri i autorizuar është kërkuar të Njoftimi për Kontrate - neni **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale** dhe të Dosja e Tenderit - Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) të **neni 7.1 & 7.2 - Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale** që do të thotë se kërkesa ka te beje me **nenin 66 të LPP- Përshtatshmëria Profesionale, (jo me kërkesat e nenit 68 dhe 69 të LPP).**

Përshkrim i Nenit 10 të LPP - Mjetet për promovimin e Transparencës, - paragrafi 3,4 dhe 5

3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.

5. Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Përshkrim i Nenit 11 të LPP - Informatat Sekrete Afariste- paragrafi 3, nen paragrafi 3.1,3.2, dhe 3.3

3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

   3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

   3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe

   3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i

tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Përshkrim i Nenit 7 të Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion- paragrafi 7.5, nen paragrafi a dhe b.

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

a. **informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe**

b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se.

Përshkrim i interpretimit të KRPP-së, nr. 31, i publikuar në Platformën e E-Prokurimit më datën 24.10.2023.

Në pajtim me nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (në tekstin e mëtejmë "LPP") duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor të nenit 10 dhe 11 të këtij ligji, si në vijim:

Neni 10 i LPP përcakton rregulla për mjetet për promovimin e transparencës, ndërsa neni 11 përcakton rregulla për klasifikimin e informatave sekrete afariste.

Në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 10 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues (siç përkufizohet në paragrafin 1, nën paragrafin 1.13 të nenit 4 të LPP-së) duhet të krijojë dhe mirëmbaj një rexhistër përmbledhës të prokurimit,

Rexhistri i tillë i prokurimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të përmbajë së paku:

(i) Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një aktivitet të prokurimit ose që janë zhvilluar apo pranuar gjatë, ose që janë mbledhur ose shfrytëzuar për të filluar ose përmbyllur një aktivitet të prokurimit, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në një kontratë ose në dhënien e konkursit të projektimit;

(ii) Nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në dhënien e një kontrate ose konkursi të projektimit, atëherë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënien e tillë; dhe

(iii) Nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në ekzekutimin e një kontratë publike, atëherë një kopje të kontratës publike dhe të të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me kontratën dhe/ose ekzekutimin e saj. Dokumentacioni në lidhje me ekzekutimin e kontratës përfshinë në veçanti planin e menaxhimit të kontratës i kërkuar sipas nenit 81 të këtij ligji.

Sa i përket qasjes në dokumente zyrtare paragrafët 3 dhe 5 të këtij neni përcaktojnë si në vijim, citat:

3. "Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur".

5. "Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar (siç përkufizohet në paragrafin 1, nën paragrafin 1.26 të nenit 4 të LPP-së), do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni".

Sipas nenit 11 të LPP-ës, si informata sekrete afariste mund të kërkohen nga OE që të klasifikohen nga AK vetëm dokumentet, dëshmitë e dorëzuara me tender të cilat janë kërkuar në Dosjen e Tenderit sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji.

Në përputhje me paragrafin 3 të nenit 11 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues mund t'i klasifikojë informatat tjera si informata sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere (kushte):

1.1 "që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

1.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe

1.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik".

Në lidhje me veprimet e AK-së për zbatim të neneve 10 dhe 11 të LPP-së, përcakton rregulla të detajuara edhe paragrafët 1-7 të nenit 7 të Rregullores për Prokurimin Publik (në tekstin e mëtejmë RRPP), si në vijim:

7.1 Tenderët në proces të tenderimit dorëzohen në baza konfidenciale. Në mënyrë që të ruhet integriteti i procesit dhe të respektohet pozita komerciale dhe konkurruese e tenderuesve, detajet e tenderëve, përveç informatave të cilat komunikohen gjatë seancës publike të hapjes, duhet të mbesin sekrete, deri në publikimin e rezultatit mbi vendimin e AK.

7.2 Qasja në të dhënat e aktivitetit të prokurimit fillon në datën e pranimit nga OE të njoftimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit – publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK.

7.3 Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuara nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.

7.4 Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete afariste, AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për më pak se 20 faqe A4 dhe qasje direkte të formës elektronike do të jenë të liruara nga tarifa.

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

a. Informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe

b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP- konfidenciale vetëm nëse:

a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "Kërkesa për sekret afarist".

b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist", të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojësë bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.

Ndërsa,

Sipas nenit 7.7 të RRPP, Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik. Për këtë qëllim, AK duhet të veprojë në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të nenit 11 të LPP-së.

Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik te cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP –së, që Ankesën tone ta konsideroje si të bazuar dhe të urdhëroje AK- Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, që të na lejon qasje në dokumentet e tenderit- Autorizimin e prodhuesit apo dilerit, të cilin së bashku me ofertën e ka dorëzuar OE: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Aneksit 5- Kërkesë për Informacione shtese, shpenzimet përgatitjes së dy Kërkesave për Ri shqyrtim dhe shpenzimet e përgatitjes së dy Ankesave për OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 24.11.2023
2. Aneksi 5- Kërkesë për Informacione shtese: 04.12.2023
3. Kërkese për Rishqyrtim: 07.12.2023
4. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 08.12.2023
5. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 11.12.2024
6. Ankesa ne OSHP- 07.12.2024
7. Vendimi i OSHP-se, nr: 2023/1027: 22.02.2024
8. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 29.02.2024
9. Procesverbali i Hapjes se Ofertave: 11.03.2024
10. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 26.03.2024
11. Kërkese për qasje ne dokumentet e tenderit: 26.03.2024
12. Përsëritje e Kërkesës për qasje ne dokumentet e tenderit:29.03.2024
13. Kërkese për Rishqyrtim: 02.04.2024
14. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 04.04.2024
15. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*